



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 27.03.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“ PËR DISA SHTESA DHENDRYSHIME NË LIGJIN NR. 103/2016 “PËR
AKUAKULTURËN”

- ***Hyrje***

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **27.03.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Për disa shtesa dhendryshime në ligjin nr. 103/2016 “për akuakulturën”*”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e përfaqësuar nga Z. Roland Kristo, Zëvendësministër

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim dhe mundëson disa rregullime në aktivitetin e akuakulturës në kuadër të një qasjeje më të afërt me fusha të rëndësishme të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës.

Projektligji jep përcaktimin e saktë të organizatave të prodhuesve në fushën e akuakulturës, funksionin dhe objektivat e tyre.

Në projektligj rregullohen edhe disa aspekte të tjera në lidhje me periudhën tranzitore të përcaktuar në ligj, me qëllim që aktiviteti i akuakulturës të zhvillohet normalisht, si një sektor i cili ashtu sikurse edhe në të gjithë botën po shndërrohet në zërin parësor të peshkimit..

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Ky projektligj përaftron pjesërisht rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe të akuakulturës, që amendon rregulloret nr.1184/2006/(KE) dhe nr.1224/2009/KE, si dhe shfuqizon rregulloren (KE) nr.104/2000 të Këshillit.

Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitullin 13 “Peshkimi”** të Planit Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) **2018-2020**.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njeh rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European*”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): Titulli III “*Bujqësia dhe peshkimi*”, neni 38 (ish-neni 32 TKE), neni 39 (ish-neni 33 TKE), neni 42 (ish-neni 36 TKE), neni 43 (ish-neni 37 TKE).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Kapitulli II “*Bujqësia dhe peshkimi*”, neni 24 “*Përkufizim*”, neni 26 (*shfuqizimi i kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore, përfshirë ato të peshkimit në tregtinë mes Shqipërisë dhe BE-së*”), neni 28 “*Produktet e peshkimit*”, Titulli VIII “*Politikat e bashkëpunimit*”, neni 96 “*Peshkimi*” dhe Shtojca III e MSA-së “*Tarifat konçensionare të BE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar*”.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- ***Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”, e ndryshuar***”.

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *Acquis* të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- ***Konsultimi publik***

Në mbledhjen e Komisionit për Integrimin European ka qënë e pranishme shoqata e Akuakulturës e cilësoi si përmirësim të situatës së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës së akuakulturës dhe institucioneve shtetërore.

- ***Efektet financiare të aktit***

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit

- ***Diskutimi në komision***

Nga komisioni u vlerësua bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit edhe në fazën negociatave.

- ***Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

Shqyrtimi i përputhshmërisë së dispozitave të projektligjit me *acquis* të be

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar **pjesërisht** me:

- ***Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 104/2000”, e ndryshuar***”.

Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.354, datë 28.12.2013, fq.1-21.

2. Në nenin 3 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi për akuakulturën të shtohen nenet 44/1 dhe 44/2, pika 2 e nenit 44/1 të riformulohet si vijon:

“2. Kur është e nevojshme, në momentin e krijimit të organizatës së prodhuesve, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.”

3. Në nenin 3 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi për akuakulturën të shtohen nenet 44/1 dhe 44/2, pika 3 e nenit 44/1 të riformulohet si vijon:

“3. Një organizatë e prodhuesve që përfaqëson aktivitetet e akuakulturës dhe të peshkimit, mund të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës.”

4. Në nenin 3 të projektligjit i cili parashikon që në ligjin në fuqi për akuakulturën të shtohen nenet 44/1 dhe 44/2, pika 3 e nenit 44/2 të riformulohet si vijon:

“3. Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues”.

• **Rekomandime**

Tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin duhet të korrigjohen nga institucioni propozues, pasi pasi projektligji të ketë hyrë në fuqi me të gjitha ndryshimet e propozuara nga Kunvedi, sepse nuk janë plotësuar sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015). Nga shqyrtimi dhe krahasimi i numrit dhe i tekstit të neneve të Rregullores së BE-së Nr.1379/2013 dhe të projektligjit, të shënuara në tabelat e përputhshmërisë, me numrin dhe tekstin e neneve të Rregullores së BE-së dhe të projektligjit është konstatuar se tabelat e përputhshmërisë kanë mangësi dhe pasaktësi të cilat duhet të korrigjohen:

Së pari, në tabelën e përputhshmërisë që shoqëron projektligjin, titulli i Rregullores (BE) Nr.1379/2013 (“Rregullore 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 dhjetor 2013 mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr 1184/2006 dhe (EC) Nr 1224 / 2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”) nuk është dhënë i plotë dhe i saktë. Titulli i plotë dhe i saktë i kësaj Regulloreje është si vijon:

“Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”, e ndryshuar”.

Së dyti, në tabelën e përputhshmërisë mungon teksti i pikës 3 të nenit 6 të Rregullores (BE) Nr.1379/2013, e cila rezulton se është përafruar nga pika 3 e nenit 44/1 të projektligjit.

Së treti, pika 1 e nenit 44/2 të projektligjit është përafuar me pikën 2 të nenit 7 të Rregullores së BE-së Nr.1379/2013 dhe jo me pikën 1 të nenit 7 të Rregullores ë BE-së siç është shënuar në tabelën e përputhshmërisë që shoqëron projektligjin.

Së katërti, në kolonën 3 “Referenca” të tabelës së përputhshmërisë, fjalët “Neni 44 i ligjit ekzistues shtohet pika 44/1” dhe “Neni 44 i ligjit ekzistues shtohen pikat 44/2”, duhet të zëvendësohen respektivisht me fjalët “Pas nenit 44 të ligjit ekzistues **shtohet neni 44/1**” dhe “Pas nenit 44 të ligjit ekzistues **shtohet neni 44/2**”. Në tekstin e nenit 3 të projektligjit të propozuar thuhet se “Pas nenit 44 shtohen nenet 44/1 dhe 44/2” dhe jo shtohen pikat 44/1 e 44/2 siç është shënuar në tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin.

Bazuar në nenin 17, pikat 3 dhe 5 të ligjit 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, KIE i kërkon institucionit propozues të projektligjit:

- *korrigjimin e tabelave të përputhshmërisë, sipas vërejtjeve të lartpërmendura, dhe ridërgimin e tyre në Kuvend,*
- *reflektimin në tabelat finale të përputhshmërisë të ndryshimeve që do të pësojë projektligji gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tij në Kuvend.*

Përfundim

- Komisioni për Integrimin Europian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
- pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI